

PROBLEME E DISKUTIME

SHABAN DEMIRAJ

RRETH NDAJFOLJËZIMIT (ADVERBIALIZIMIT) TË DISA FORMAVE GRAMATIKORE DHE TË DISA TOGJEVE TË TIPIT PARAFJALË + EMËR

1. Një problem i pasqaruar ende kënaqshëm në gjuhësinë tonë (dhe jo vetëm në gjuhësinë tonë) është edhe ai i kalimit të një forme emërore a foljore ose të një togu të tipit parafjalë + emër në klasën e ndajfoljevet. Zgjidhja e këtij problemi ka rëndësi jo vetëm praktike por edhe teorike. Mjafton të kihet parasysh qëndrimi i ndryshëm, që mbahet lidhur me përcaktimin e përkatësisë kategoriale të formave të tipit *ditën, natën, të enjten* etj., *verës, dimrit* etj., *rrugës, malevet* etj.¹

1) Këtu po shënojmë se ç'qëndrim është mbajtur në disa gramatika të gjuhës shqipe dhe në dy studime kushtuar ndajfoljevet lidhur me format në fjalë:

S. Frashëri në *Shkronjëtores e gjuhësë shqip*, f. 130, shënon se si ndajfolje kohe përdoren edhe emrat, që tregojnë kohë, në rasën kallzore, si *ditënë, natënë*.

I.D. Sheperi në *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, 122, shën. 3, pohon: «Si ndajfolje përdoren dhe: a) rasa emërash: shkoj *udhës*. b) pjesoret: punofsh *gëzuar!*».

O. Myderrizi në *Gramatika e re e shqipes*, f. 272, shënon: «Si ndajfolje vendi përdoren edhe disa emna në rasën rrjedhore të shqueme e të pashqueme: Shkoj *fushës*. U suell *kodrash*». Dhe pak më poshtë: «Si ndajfolje kohe, përdoren edhe disa emna në rasën kallzore të shqueme: *Natën* ban ftohët e ditën vapë. *Të djelën* do të shkojmë në Dajt». Në f.273 ai shënon se si ndajfolje mënyre përdoren edhe pjesoret si: shkoj *gëzue*. Hecte *zbathtë*.

K. Cipua në *Gramatika shqipe*, f.180, shënon si ndajfolje kohe edhe: *ditën* (nëpër diell), *natën* (nëpër hënë), *verës, dimrit*; kurse në f.181 shënon si ndajfolje vendi edhe: *rrugës, fushës, malit*.

A. Xhuvani në *Studime gjuhësore* (Tiranë, 1956), f.194, shënon si ndajfolje edhe: ja tha copë, e ngre *peshë*, e qiti *gisht*, eci *vrap*, shkoj *këmbë, faqe, mot, vjet* (emnore); *ditën, natën, vitin, motin* (kallzore); *dimnit, verës, motit, javës, udhës, malit* (rrjedhore e njëjësit); *malevet, rrugëvet, premanet, natënet*, (këto rrobe i vesh) *Pashkëshit*, (më duel) *hundëshit*, (lodhem) *kambësh*, (krihem) *flokësh*, lahem *shtetsh* (rrjedhore e shumësit).

M. Domi në *Gramatika e gjuhës shqipe*, pj. II — Sintaksa (Tiranë, 1955) në ndërtimet e tipit: Luaj *vendit*. Eca *hijes*. Mos rrihi *rrugëve*. (f.107), *Dimrit* unë vesh çorape leshi. Gjithë *natën* ka rënë shi. Verës unë mbaj çorape pambuku. Një *viti* unë kam qenë në Dardhë, (f. 112), fjalët e nënvizuara i quan emra.

Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, dispensa II, f. 260-261 format e tipit *ditën, natën, verës, dimrit* etj., *rrugës, anës; rrëzës* etj. i trajton si forma emërore. Ai anon nga ky mendim sepse ato «nuk përdoren me ndonjë kuptim të ngushtuar ose të zgjëruar... dhe, nga ana tjetër, mund të përcaktohen edhe me fjalë të tjera, që luajnë rolin e një cilësori, të një ndajshtimi a të një plotësi tjetër, kurse ndajfoljet nuk marrin pas tyre ndonjë cilësor ose plotësi tjetër». Ai shton se disa nga format e këtij tipi mund të përdoren edhe me parafjalë.

Xh. Lloshi në artikullin *Shënime për fjalën dhe togfjalëshin*, «Stud. fil.» 4, 1966,

Të kihet parasysh edhe paqartësia që vihet re shpesh në praktikë lidhur me lokucionet ndajfoljore².

Arësyeja e mungesës së një qëndrimi të qartë dhe të përbashkët lidhur me ndajfoljëzimin e një forme emërore a foljore ose të një togu të tipit parafjalë + emër kuptohet lehtë, po të kihet parasysh se në shumicën e rasteve interpretimi i të dhënave gjuhësore nuk është bërë në bazë kriteresh të përcaktuara mirë e drejt, por vetëm në bazë interpretimesh subjektive, në mjaft raste nën ndikimin e modeleve të huaja.

Prandaj për një zgjidhje të drejtë të problemit në shqyrtim është

186 v., bën fjalë për disa emra me kuptim kolektiv, të cilët «për shkak të semantikkës së tyre përdoren si ndajfolje» dhe shton: «Me përdorim kuptojmë shkallën e ndërmjetme nga emri tek ndajfolja, atë shkallë kur ndryshimi i brendshëm semantik i fjalës nuk ka gjetur përfundimisht edhe formësimin e jashtëm gramatikor». Këtu ai ka parasysh emra të tipit *stivë* në shprehje të tilla si: *vë stivë, bëj stivë* etj.

E. Hysa në një studim kushtuar ndajfoljeve (ende i pabotuar) format e tipit *ditën, natën, të enjten* etj., *verës, dimrit, udhës, anës* etj. i trajton si ndajfolje. Format e tipit *dimrit*, kur ndiqen nga një përcaktor dhe prihen nga një parafjalë, ai i trajton «si kalimtare që po prirën nga ndajfoljet». Si forma «në gjëndje kalimtare» janë, sipas tij, edhe format e tipit *maleve, udhëve, rrëzave, hijeve* etj. Ai bën fjalë edhe për «ndajfoljëzim kontekstual» dhe këtu ka parasysh rastet kur disa emra «vetëm në kontekste të caktuara përdoren si ndajfolje». Ai shton se në ndajfoljëzimin e emrave përveç formës së tyre, që luan «rol kryesor», një rol të rëndësishëm luan edhe funksioni i tyre sintaksor dhe përfundon se në çdo rast duhet pasur parasysh konteksti, «i cili këtu luan rol drejtues».

2) S. Frashëri, *vep. cit.*, 130, shënon se si ndajfolje kohe përdoren edhe «shumë emëra bashkë me një parje [=parafjalë]» si: *për herë, në mëngjest, më të nesërmet*.

O. Myderrizi në gramatikën e tij si lokucione ndajfoljore përmend, ndër të tjera: *më një anë, m'at'anë, për ditë, për javë, ditë për ditë* (f.272), *me mend, pa kujdes, për bukuri, për dhunë, pa hir, me të butë, me të keq* (f.273).

K. Cipua në gramatikën e tij si lokucione ndajfoljore përmend, ndër të tjera: *asi vakti, më në funt, me mëngjes, me pulat, sa çel e mbyll sytë, mbë të ngrysur, para tri ditësh, gjithë ditën, gjithë natën e lume, tërë natën, pa gdhirë, pa dalë ujku nga fshati, Shën Gjergjit* (f.180); *nga çdo anë, mbë çdo anë, mbë n'janë, mbë këtë anë, m'at'anë, mbë të djathtë (djathtas), mbë të mëngjër (majtas), për ballë, në mest, mbë ijë, mbë dhe* (f.180-181); *me të shpejtë; për fat, me të mirë, me të keq, me zi* (f.181).

A. Xhuvani në *Studime gjuhësore*, f. 199 bën fjalë për lokucionet ndajfoljore, «që formohen prej dy a ma shumë fjalësh të lakueshme a të palakueshme dhe të bashkueme ose jo me parafjalë». Si lokucione ndajfoljore të formuara prej një parafjale dhe një emri, ose mbiemri (a pjesoreje), a përemri, ai rendit: *me vrap, me mend, me vend, me zemër, me shkop, me shpirtit, me urdhërit, me kohë, me ne, me turp* etj., *pa mëshirë, pa pushim, pa turp, pa da, pa aguem, pa gdhirë, pa ëngjëlluar, pa ju, pa kohë, pa fund* etj., *më derët, më buzët, më kambë etj.*; *mbi dhet, mbi boshtit, mbi mua, mbi kurris, mbi rruzë, mbi supet* etj.; *në pust, në shit, në borët, në luktit, në barkut, në zemërt* etj.; *nënë gurt, nënë dardhëti, ndën tokë, ndën atë, ndën dorë* etj.; *nga mot, nga vjeshta, nga pazari* etj.; *për tokë, për truall, për ditë, për dhunë, për gryke, për dore, për veshi, për tyj, për hundësh* etj.; *deri mot, gjer vjeshtës, mje në krahënuer* etj. *ndaj meje, ndaj syresh, ndaj gravet* etj.

Si lokucione ndajfoljore të formuara «prej një parafjale dhe gjinisë asnjansë të mbiemrit, që mirret si emën abstrakt», ai përmend: *me të mirë, me të egër, me të butë, me të shpejtë, me të drejtë, (mbahem) me të madh, ndaj të gdhirë, ndaj të ngrysur*.

Sh. Demiraj në *vep. cit.*, 263 v. pohon se si lokucione ndajfoljore do të merren «ato grupe fjalësh të adverbializuara, që nuk janë ngjizur ende në një fjalë të vetme. Grupet e fjalëve, që merren si lokucione ndajfoljore, nga përdorimi i gjatë dhe i dëndur janë kristalizuar në mënyrë të tillë që zakonisht nuk lejojnë t'u shtohet ose t'u hiqet ndonjë fjalë. Të tilla janë në gjuhën shqipe një varg lokucionesh të formuara nga togu parafjalë + emër ose mbiemër i substantivuar etj. si p.sh.: *me hir, me (të) pahir, me të mirë, me të keq, me të drejtë, pa të drejtë, për herë, për bukuri, për çudi* etj.»

J. Thomaj në artikullin *Një klasifikim i frazeologjizmave me vlerë ndajfoljore*

e domosdoshme që më parë të përcaktohen mirë kriteret gjuhësore përkatëse. E, duke qenë se pjesët e ligjëratës janë kategori leksiko-gramatikore, ne mendojmë se, edhe për të përcaktuar nëse një formë emërore a foljore ose një tog i tipit parafjalë + emër ka kaluar në klasën e ndajfoljevet apo jo, duhen marrë në vështrim si ana leksikore ashtu edhe ana gramatikore. Të dyja këto anë, sipas mendimit tonë, duhen pasur parasysh për çdo rast konversioni të në fjale nga një pjesë e ligjëratës në një tjetër, si p.sh. për substantivimin e mbiemrave, adjektivimin e emrave etj. Përndryshe, interpretimet subjektive janë të pashmangshme.

Sipas mendimit tonë, një formë emërore ose foljore ka kaluar në klasën e ndajfoljevet vetëm atëherë kur:

1) Ka pësuar ndryshime të rëndësishme në përmbajtjen kuptimore duke u shndërruar kështu në një njësi të re leksikore me një kuptim të ri kategorial.

2) Si rrjedhim, ka humbur veçoritë gramatikore të pjesës së ligjëratës, së cilës i përkiste, dhe ka marrë tipare gramatikore karakteristike për ndajfoljet, siç janë mungesa e fleksionit, nga njëra anë, dhe kategoria e shkallëve të krahasimit, nga ana tjetër.

3) Përdorimi i saj me vlerë ndajfoljore nuk është i kufizuar funksionalisht në një rast të izoluar.

2. Për sa i takon kushtit të parë, kemi parasysh në radhë të parë ndryshime të tilla të karakterit leksikor, që nuk na lejojnë ta konsiderojmë kuptimin e formës në shqyrtim si një kuptim të dytë (a të tretë etj.) të fjalës përkatëse. Në këtë rast kemi të bëjmë me një ndryshim të kuptimit kategorial të fjalës, siç ka ndodhur, p.sh., me format e ngurosura të kallëzores së pashquar njëjës *mot*, *vjet*, si edhe me format e ngurosura të rrjedhores së shquar, përkatësisht të pashquar njëjës, *heret*, *motit*, *krejt*, *fare*, *sheshit* (në kuptimin *hapur*). Ndryshim të kuptimit kategorial, sipas mendimit tonë, kanë pësuar edhe:

1) Pjesoret *shkoqur*, *shtruar*, *hapur*, *prerë* etj., kur përdoren jo me kuptimin e tyre të zakonshëm foljor, por përkatësisht me kuptimin *qartë*,

në gjuhën shqipe, «Stud. fil.», 1, 1969, 3-46, ku merret gjërë e gjatë me frazeologjizmat me vlerë ndajfoljore «që përbëhen prej jo më pak se dy fjalësh shënuese», trajton shkurt (f.4-5) edhe disa «lokucione» ndajfoljore të tipit parafjalë + emër si: *me këmbë, nën dorë, me një frymë, nën gunë, nën hundë, nën lëkurë, nën rrogog, në tym, ndër sy, pas shpine, prapa diellit, prapa kraheve, për një qime* etj. Ai shton se këto «lokucione» kanë karakter idiomatik, «të fituar nëpërmjet një shndërrimi figurativ të kuptimit» dhe «janë ekuivalentë të ndajfoljeve të thjeshta *keq*, *fshehurazi*, *shpejt*, *kot*, *haptazi*, *larg* etj. (me dallimin në përmbajtje dhe në vlerën ekspresive)».

E Hysa në studimin e cituar, duke bërë fjalë për ndajfoljësimin e togjeve të tipit parafjalë + emër, vë në dukje se ky proces përftohet atëherë kur dobësohet lidhja kuptimore midis parafjalës dhe emrit, duke u përdorur ky i fundit «me një kuptim mjaft të përgjithshëm».

Nga të tilla «lokucione», që ndërtohen me parafjalë të ndryshme, ai përmend:

I) me parafjalën *me*: a) *me egërsi, me kohë, me natë, me ngashërim, me nxit, me nxitim, me orë, me padurim, me qesëndi* etj.; b) *me të butë, me të egër, me të mirë, me të keq, me të ngutur, me të pabesë, me të qeshur, me të tallur, me të urtë, me të vështirë*, etj.

II) Me parafjalën *për*: *për një çast, për ditë, për një hop, për një herë, për ibret, për jetë, për një kohë, për mot, për natë, për orë, për vit, për turp* etj. (f.79).

III) Me parafjalën *nga*: *nga ditë, nga herë, nga mot* etj. si edhe *nga hera, nga dita*, f. 80.

IV) *Prej kohe e prej kohësh, në këmbë e më këmbë, në çast, në minutë, më tym* etj.

pa u rrëmbyer, *haptas*, *prerazi*, si p.sh. në ndërtime të tipit: (Ai) fliste *shkoqur* (*shtruar*, *hapur*, *prerë*)³.

2) Format e pashtjella me kuptim mohor *pa pandehur*, *pa pritur*, *pa rreshtur* etj. kur përdoren jo me kuptimin e tyre të zakonshëm foljor, por në kuptimin *befas*, *papritmas*, *pa pushim*, duke treguar kështu një tipar të foljes. P.sh.:

... dhe, pasi u ngrohën mirë e mirë, se bënte ftotë, u shtrijtën. Kur përnjëherë, fap! ja bëri *papandehur*, erdhi tabakaja përpara me kafe. (Proza popullore, vëll. IV, Tiranë 1966, f. 503). Ne po kalonim nën ca kolona të trasha, kur unë *papritur* ngrita kokën dhe u mahnita. Ai vështronte *padashur* pushkëhë e varur në mur dhe digjej nga dëshira ta rrëmbente atë... (I. Kadare, *Dasma*, 86, 30). -Si vdiq *kaqë pandehur?* (S. Spasse, *Afërdita përsëri në fshat*, 192)

* * *

Në ndryshimet me karakter leksikor do të përfshihet edhe rasti, kur një fjalë, p.sh. me origjinë emërore, në shqipen e sotme nuk përdoret më në të gjitha format rasore përkatëse, por vetëm në një formë rasore të ngurosur. E tillë është forma e ngurosur e rrjedhore së *pashquar* njëjës të *mbiemravet* ose të rrjeshtorëve të *substantivuar* asnjënjës të tipit *së larti*, *së gjati*, *së gjëri*, *së mbari* etj.; *së pari*, *së dyti*, *së treti* etj.

3. Lidhur me kushtin e dytë të ndajfoljësimit ne kemi parasysh ato raste, kur një formë emërore ose foljore, si rrjedhim i ndryshimevet të karakterit leksikor, vjen e nguroset, d.m.th. humbet të gjitha kategoritë gramatikore emërore ose foljore, duke humbur kështu edhe aftësinë e lidhjevet sintaksore të mëparshme dhe duke marrë në të njëjtën kohë funksione sintaksore të ndajfoljevet. P.sh., nga kjo pikëpamje, një formë emërore do të konsiderohet e çsubstantivuar atëhere kur i ka humbur kategoritë gramatikore të emrit (gjini, numër, rasë edhe kundërvënjen shquarësi/pashquarësi) si edhe aftësinë e lidhjevet sintaksore të emrit. Kuptimi, që ka marrë në gjëndjen e saj të ngurosur, nuk e lejon atë të shërbejë si përcaktor i një emri tjetër dhe as të përcaktohet nga një *mbiemër* ose nga një emër tjetër, ose nga një fjali përcaktore lidhore.

Procesi i çsubstantivimit të një forme emërore të dhënë në këtë rast është i lidhur ngushtë me atë të ndajfoljësimit të saj. Madje, këto dy procese duhen marrë si dy aspekte të një procesi të vetëm. Në këtë rast çsubstantivimi e ka burimin tek përdorimi i formës emërore të dhënë në një funksion, i cili si kuptimisht ashtu edhe gramatikisht është karakteristik për ndajfoljen; nga ana tjetër, kalimi përfundimtar i formës emërore në klasën e ndajfoljevet është i kushtëzuar pa tjetër nga çsubstantivimi i saj.

Këto vërejtje vlejnë edhe për ndajfoljësimin e pjesores dhe të formës së pashtjellë të tipit *pa pandehur*. Ndajfoljësimi i këtyre formave të pashtjella nuk paraqit ndonjë vështirësi të karakterit formal. Por ato do të konsiderohen të ndajfoljësuar vetëm atëhere kur si kuptimisht ashtu edhe gramatikisht kanë marrë tipare ndajfoljore. Nga pikë-

3) Kur pjesorja përdoret në funksion kallëzuesor nuk është e ndajfoljësuar. Si rrjedhim, mendimi i I.D. Sheperit (*Gram.* 122, shën. 3) se në shëmbëllën *punofsh gëzuar*, dhe ai i O. Myderrizit (*Gram.* 273) se në shëmbëllat — *Shkoi gëzue. Hecte zbatë*, pjesorja përdoret si ndajfolje mënyre, nuk janë të saktë.

pamja gramatikore si tipar i ndajfoljësimit të pjesores do të merret përdorimi i saj si plotës mënyre, funksion ky, në të cilin pjesorja si e tillë nuk përdoret. Kurse si tipar gramatikor i ndajfoljësimit të formës së pashtjellë të tipit *pa pandehur* është humbja e kategorivet gramatikore foljore si edhe e aftësisë për të marrë kryefjalë, kundrina dhe plotës të tjerë.

4. Kushti i tretë i ndajfoljësimit të një forme emërore ose foljore është pasoja e drejtpërdrejtë e plotësimit të dy kushtevet të para. Kur një formë emërore ose foljore pëson ndryshime të rëndësishme të karakterit leksikor e gramatikor (shih më sipër §§ 2, 3) dhe merr kuptim e tipare ndajfoljore, me kalimin e kohës ajo fiton aftësinë që të përdoret si ndajfolje në një numër gjithnjë e më të madh rastesh, duke mos mbetur kështu e kufizuar funksionalisht në një rast të izoluar. Përndryshe, procesi i ndajfoljësimit nuk mund të konsiderohet i përfunduar. P.sh. forma e rrjedhore së shquar *sheshit*, kur përdoret në kuptimin *sheshazi*, *hapur*, *qartë*, duke humbur, si rrjedhim, edhe tiparet gramatikore të emrit, si ndajfolje ka ardhur duke u përdorur me një numër gjithnjë e më të madh foljesh⁴, si p.sh. Kjo punë duket *sheshit*. Këto argumente tregojnë (dëshmojnë, provojnë etj.) *sheshit* se..., Madje, si ndajfolje ajo ka mundësi të përdoret edhe në kuptimin e shkallës sipërore absolute, duke marrë përpara ndajfoljen *fare* P.sh. «Kjo tregon *fare sheshit* se parimet e respektimit të sovranitetit e të mosndërhyrjes në punët e brendëshme të njëri-tjetrit, për të cilat flasin revizionistët, janë një paçavure pa vlerë...» (Zëri i popullit», 15.VII.1969, f. 4). Po ashtu edhe forma e pashtjellë mohore *pa pandehur*, kur përdoret në kuptimin *befas*, *papritmas*, duke humbur, si rrjedhim, edhe tiparet gramatikore të foljes, si ndajfolje ka ardhur duke u përdorur me një numër gjithnjë e më të madh foljesh (dhe emrash prejfoljorë asnjansës), si p.sh. Ai erdhi (u kthye, u nis, u largua, u ngrit, u ul, u pendua etj.) *papandehur*.

5. Për lokucione ndajfoljore⁵ të formuara nga togje të lira të tipit parafjalë + emër mund të bëhet fjalë vetëm atëherë kur pjesët përbërëse të tyre si kuptimisht ashtu edhe gramatikisht janë shndërruar, si të thuash, në një njësi të pandashme me vlerë dhe tipare ndajfoljore. Në këto lokucione ndajfoljore si parafjala ashtu edhe emri pas saj e kanë humbur, diku më shumë e diku më pak, mëvetësinë e tyre si fjalë të veçanta. Kjo ndodh sidomos tek lokucionet ndajfoljore me kuptim të figurshëm si në *tym* (=kot më kot), *me natë* (shumë heret në mëngjes),

4) Shih edhe *Fjalor i gjuhës shqipe* (1954) f. 519.

5) Me lokucion ndajfoljor ne kuptojmë një grup fjalësh, që kanë një lidhje të qëndrueshme midis tyre dhe që si kuptimisht ashtu edhe gramatikisht janë të barazvlerëshme, por jo identike, me një ndajfolje. Lokucioni ndajfoljor, si kuptimisht ashtu edhe gramatikisht, zë një pozitë të ndërmjetme midis togut të lirë dhe fjalës (në këtë rast, ndajfoljes), por duke qëndruar më afër kësaj të fundit. Me kalimin e kohës pjesët përbërëse të një lokucioni ndajfoljor mund të përngjiten në një fjalë të vetme, duke kaluar kështu përfundimisht në klasën e ndajfoljevet. Një dukuri e tillë është vërtetuar, p.sh., tek ndajfoljet *prorë* (<për orë), *pranë* (<për anë), *ndanë* (<ndë anë), *matanë* (<më atë anë) etj. ose tek ndajfoljet *ngoje*, *ndore*, ku *n-*, pas gjithë gjasash, është një parafjalë e vjetër e rrjedhore, për të cilën shih E. Çabej, *Gjon Buzuku*, «Bul. për shk. shoq», 4, 1955, 115. Të kihen parasysh edhe ndajfoljet *sonte* (<*so nate), *sot* (<*so dite), *sivjet* (<*si vjeti), *atëherë* (<atë herë) etj. që dikur kanë qenë togje të lira; këto togje, para se të përngjiteshin, duke kaluar kështu në klasën e ndajfoljevet, duhet të jenë përdorur për një kohë si lokucione ndajfoljore.

nën dorë (= fshehurazi), prapa diellit (= shumë larg) etj.⁶ Në lokucionet ndajfoljore të këtij tipi as parafjala nuk përdoret, si zakonisht, për të shprehur lidhjen sintaksore të emrit pas saj, as ky i fundit nuk përdoret me kuptimin e tij të zakonshëm (kategorial). Si rrjedhim, emri në këto lokucione çsubstantivohet, duke humbur si kategoritë gramatikore përkatëse ashtu edhe aftësinë e lidhjevet të tij sintaksore, pasi nuk ka mundësi të marrë, para ose prapa, përcaktorë me ose pa përshtatje, çka nuk ndodh tek togjet e lira. Të krahasohet p.sh. (Ai flet) *në tym* me (Ai shkoj) *në shtëpi*, *në një shtëpi të re*, *në shtëpinë e një shoku* etj.⁷

Por ka edhe disa lokucione të tjera ndajfoljore të tipit parafjalë + emër, që nuk kanë kuptim të figurshëm, si *me radhë*, *me nxit*, *në këmbë* etj. Edhe pjesët përbërëse të këtyre lokucioneve e kanë humbur mëvetësinë si fjalë të veçanta, sidomos nga pikëpamja gramatikore. Edhe në këto lokucione, ashtu si tek ato të tipit *në tym*, emri i humbet kategoritë gramatikore dhe aftësinë e lidhjevet sintaksore. Në të tilla rrethana edhe parafjala e humbet aftësinë e saj kombinatorë, duke qenë se përdoret vetëm para një emri në formë të ngurosur⁸. Edhe nga pikëpamja kuptimore togjet e këtij tipi janë të barazvlershme me ndajfoljet, madje më ndonjë rast edhe mund të zëvendësohen prej tyre, si p.sh. *me radhë:radhzai*. Por do pasur parasysh se shkalla e ndajfoljërimit të këto lokucione është më e vogël se tek ato që kanë kuptim të figurshëm.

*
* *

Përveç këtyre, sipas mendimit tonë, duhen marrë si lokucione ndajfoljore edhe:

1) Togjet *nga herë*, *nga ditë*, *nga mot*, në të cilat emrit në trajtë të pashquar i prin fjalëza me origjinë parafjalore *nga*⁹, e cila këtu për nga kuptimi afrohet me përemrin e pakufishëm *çdo*. Në këto togje emri nuk mund të përdoret i prirë nga *nyja një* dhe as në trajtë të shquar; ai ka humbur edhe aftësinë e lidhjevet sintaksore, duke qenë se nuk mund të ndiqet nga një përcaktor me ose pa përshtatje. Tek variantet *nga hera*, *nga dita*¹⁰ -a s'është gjë tjetër veçse prapashtesa -a, që u ngjitet

6) Për këto shih edhe A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe»*, «Stud. fil.», 2, 1968, 85.

7) Siç del edhe nga këta dy shembuj të krahasuar, në lokucionet e tipit *në tym*, duke qenë se emri përdoret në një formë të ngurosur, edhe vetë parafjala e humbet aftësinë e saj për t'u përdorur para të njëjtit emër në trajtë të shquar, përkatësisht të pashquar, të prirë nga *nyja një* ose nga ndonjë tjetër përcaktor, ose të ndjekur nga një përcaktor me ose pa përshtatje.

8) Shih shënimin 7.

9) G. Meyer-i, *Etymologisches Wörterbuch*, f. 304, si edhe E. Çabej në një nga *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe* (ende të pabotuar) kanë shprehur mendimin se *nga* e përdorur me kuptim distributiv është e njëjta fjalë, për nga origjina, me parafjalën *nga*.

Tek arbëreshët e Italisë distributivja *nga* përdoret relativisht më shumë se në të folmet e Shqipërisë; tek ata e gjejmë të përdorur edhe me forma gramatikore, që s'mund të interpretohen ndryshe veçse si forma të rasës kallëzore. P.sh.;

Nka të shtunë ti m'i tagjis,
m'i tagjis e m'i potis,
nka të diel m'i nëmëro...

(Poezija popullore arbëreshe, botuar nga Z. Kodra, Tiranë 1957, f. 128-130).

10) Tek *Fjalor i gjuhës shqipe* (1954), f. 344, *ngahera* jepet si ndajfolje dhe shkruhet si një fjalë. Edhe në *Rregullat e drejtshkrimit të shqipes* (projekt), Tiranë, 1967, *ngadita*, *ngahera* dhe *ngaherë* shkruhen si një fjalë.

disa ndajfoljeve ¹¹. (Të kihen parasysh edhe *për hera, për dita* etj.). Për këto arësye fjalëza nga në këto togje nuk funksionin as si parafjalë as si përemër i pakufishëm. Edhe nga pikëpamja semantike togjet nga *herë, nga ditë, nga mot* kanë ardhur duke iu afruar gjithnjë e më shumë kuptimit të ndajfoljeve *kurdoherë, gjithmonë*.

2) Togjet e tipit *me + emër prejmbiemëror* i gjinisë asnjane, përkatësisht femërore me vlerë asnjani (si p.sh. *me të keq, me të mirë, me të egër, me të madhe* etj.), si edhe togjet e tipit *me + emër prejfoljor asnjane* ¹² (si p.sh. *me të qeshur, me të tallur, me të drojtur* etj.). Edhe në këto togje emrat përdoren në një formë të ngurosur, duke humbur kështu kategoritë gramatikore dhe lidhjet sintaksore të emrit. Kjo dukuri tek togjet në shqyrtim do lidhur edhe me faktin se emrat prejmbiemërorë dhe prejfoljorë të gjinisë asnjane e kanë humbur gjallërinë e dikurshme dhe, si rrjedhim, në shqipen e sotme jashtë lokucioneve në shqyrtim ose nuk përdoren fare ose sa vijnë e po përdoren gjithnjë e më pak. Si rrjedhim, edhe parafjala *me* në këto togje e ka humbur aftësinë e saj kombinatorë ¹³. Në të tilla rrethana togjet e tipit *me të keq, me të qeshur* janë shndërruar në lokucione të ngurosur, që edhe kuptimisht janë të barazvlershme me ndajfoljet. Për lokucionet në shqyrtim mund të pohohet se shkalla e ndajfoljësimit është më e madhe në ato raste kur emri prejmbiemëror ose prejfoljor asnjane nuk përdoret më jashtë lokucionit ndajfoljor. Sa për ilustrim po renditim këtu disa shembuj me lokucione ndajfoljore të këtij tipi.

a) I porositi që, *me të mirë* e *me të egër*, të kthejnë pazarin te vendi i parë... Vjet të thamë *me të urtë* ... Sivjet do të ta marrin *me të keq*... Dafina i qe përgjigjur *pa të keq*... vdekja, o Kolë Shpërvjeli, nuk ndan, po bashkon edhe ata që mbahen *më të madh*... (J. Xoxa, Lumi i vdekur, I/27, III/97; II/228; III/84). Ai qeshi *me të madhe* (I. Kadare, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, bot. I, f. 66).

b) Djaloshi... i tha *si me të lutur*. Miq të s'vijnë kështu *me të drojtur*.. Miti i hodhi një vështrim dashmirës dhe ai iu përgjigj gjithashtu me një lëvizje të qeshur të syve pak *si me të mburrur*...; ... dhe, si zbriti shkallët e i tha diçka plakës *me të qeshur*, u drejtua për te porta. (Sh. Musaraj, Para agimit, I/114, II/98, 314, 211).

6. Por, kur nuk plotësohen kushtet e lartpërmendura, atëhere nuk mund të bëhet fjalë për ndajfoljëm të një forme (emërore a foljore) ose të një togu parafjalor. Kështu, sipas mendimit tonë, format e emrave me kuptim të përgjithësuar në rasën kallëzore të shquar njëjës pa parafjalë *ditën, natën, të hënën, të martën* etj. ose në rasën rrjedhore të shquar njëjës pa parafjalë *verës, dimrit, pranverës, vjeshtës* etj., kur përdoren si plotës kohe, nuk janë të ndajfoljësuar, siç paraqiten nga disa gjuhëtarë ¹⁴. Ato nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim të kuptimit kategorial, por përdoren me kuptimin e tyre të përgjithësuar (nacionor), në kundërvënje dy nga dy (*ditën-natën, verës-dimrit, pranverës-vjeshtës*), ose duke u kundërvënë njëra kundër të tjerave (si p.sh. *e hëna kundër ditëve të tjera të javës, e kështu me radhë*). Ato nuk e kanë humbur

11) Shih A. Xhuvani — E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, f. 6.

12) Natyrisht këtu është fjala për ato raste, në të cilat togu i tipit *me + emër prejfoljor asnjane* nuk ka marrë vlerë foljore; shih për këtë artikullin tonë në «Stud. fil.» 2, 1969, 48 v.

13) Shih shën. 7.

14) Shih shën. 1.

as aftësinë e lidhjevet sintaksore të emrit, sepse mund të marrin përcaktorë mbiemërorë e emërorë (me ose pa përshtatje, me ose pa parafjalë), ose mund të ndiqen nga një fjali përcaktore lidhore. Është e vërtetë se, kur marrin ndonjë a më shumë përcaktorë ose ndiqen nga një fjali përcaktore lidhore, kuptimi i tyre ngushtohet ose individualizohet, por kundërvënja kuptim i përgjithësuar / kuptim i individualizuar nuk del jashtë caqevet të emrit¹⁵. Një gjë e tillë u ndodh emravit me kuptim të përgjithësuar (duke përfshirë emrat në shqyrtim), edhe kur përdoren në rase të tjera. P.sh. të krahasohen:

1) *Dimri* është stina më e ftohtë e vitit. Muajt e *dimrit* janë

2) *Dimri* i vitit të kaluar qe shumë i ftohtë. Ditët e para të *dimrit*, që shkoi, bënë shumë ftohtë.

Veç kësaj do pasur parasysh se format e rrjedhore së shquar njëjës *verës, dimrit* etj. me kuptim të përgjithësuar, në funksionin e plotësit të kohës mund të shoqërohen edhe me ndonjë parafjalë (kryesisht me parafjalët me origjinë ndajfoljore *gjatë, pas*). *Gjatë verës* fëmijët shkojnë nëpër kampet e pionierëvet. *Pas verës* vjen vjeshta.

Gjithashtu do pasur parasysh se në vend të formavet të kallëzores së shquar njëjës, *ditën, natën, të hënën* etj. (me kuptim të përgjithësuar) mund të përdoret me të njëjtin funksion kohor edhe forma e dhanores së shquar shumës (*netëve(t), të hënave(t)* etj.), e cila në këtë rast ka vlerën e rrjedhore; në shumës, në vend të formës *ditën*, haset edhe forma e kallëzores së shquar (*ditët*), e ndjekur nga një përcaktor emëror ose mbiemëror. Për sa u tha gjer këtu, po japim disa shëmbëlla sa për ilustrim:

a) ... *ditënë* mentonem, /*natën* rri pa gjumë. (A. Çajupi, Baba-Tomorri dhe shkrime të tjera: Tiranë, 1950, f. 43). — Po qysh, moj motra, i zbuam *natën*, thatë? ... pyeti *këtë radhë* plaka e Papuçinjve. — E ku ua gjet, që i gjet e keqja, sot, *ditën e të vdekurve...* *Natën e parë të acarit...* ngakiet, jeshilsit, fishkllemat... qëndruan atje në zemër të moçalit... *Ditën e tretë të thëllimës s'pritën* fare sa të errësohej. *Një natë të tillë të ftohtë dimri* vetëm yjet në qiell ndihen gjallë. *Këtë natë*, në Trokth gjishtëj një oborr, që as e ftohta, as errësira e shtyrë e mbrëmjes nuk e kishte pas-truar nga njerëzit dhe kafshët. *Atë natë* kishte parë ëndër sikur... (J. Xoxa, Lumi i vdekur, I/12, 12; II/7, 7; I/241, 242, 215, 214). *Të prëmtën* edhe *të shtunë* /u zu dyfeku në Tunë/ me topa me gjyle shumë./ Prap *të djelën e dyjtë* prifti u dha atë pyetje fshatarëve... (Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, vëll. II, Tiranë, 1961 — f. 230; vëll. III — Tiranë, 1962, f. 260). Mirë, baba, kur paske qejf të bëjmë pazar *ditë të hënë...* Suat bej Vërdhoma pasi kishte ardhur *që të prëmtën* në Trokth, qe nisur për në qytet të nesërmen, me të marrë vesh arratinë e Vitës... (J. Xoxa, Lumi i vdekur, I/214; III/257). *Gjithë natën* s'kishin mbyllur sy... (V. Kokona, Me valët e jetës, I, 27). Ku ke parë ti anëtar fronti të kërcasë gishtërinjtë *gjithë ditën* e perëndisë në një kohë kur populli po e bën *natën ditë*? (Sh. Musaraj, Isha unë Çobo Rapushi, 28).

15) Ndryshe qëndron puna në gjuhë të tilla si gjermanishtja, ku emrat e tipit *ditën, natën, verës, dimrit* etj. me kuptim të përgjithësuar, kur shërbejnë si plotës kohe, përdoren në një formë të ngurosur, pra, paraqiten formalisht të ndajfoljësuar. Ata zakonisht përdoren me prapashtesën ndajfoljësuese -s, si p.sh. *Tags, Nachts, Sommers, Winters* etj., megjithëse në atë gjuhë përdoren edhe ndërtimet me parafjalë si *am Tage, in der Nacht* etj. (shih për këto H. Paul, *Deutsche Grammatik*, III, 372 v.). Të kihen parasysh edhe shprehjet e ndajfoljësuar *di giorno, di notte, d'estate, d'inverno* etj. të italishtes dhe *de jour, de nuit* etj. të frëngjishtes.

b) Tashti *dimërit* ku ka lëndinë të njomë? (Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, vëll. II, Tiranë, 1961, f. 255). Ma ka ba zoti nafakë, /*Verës* n'bjeshkë, *dimnit* n'çardak. (Këngë popullore lirike, Tiranë, 1955, f. 104)... po vijnë si vjen *pranverës* një vërshim. (Ll. Siliqi, «Zëri i Popullit», 20.IV.1969, f. 3). Këtu u dha rasti të kritikohen konkretisht disa prindër, që edhe fëmijët e vegjël i vënë në punë të rënda *gjatë verës*... (gaz. «Mësuesi», 14.VI.1969, f. 1).

c) Në familjen Velo, *pasdarkeve* dhe sidomos të *dielave* ose *ditët e festave*, vinin për vizitë gjithëfarë njerëzish. (Sh. Musaraj, Para agimit, I/23). Papo ja shtroja *mëngjezeve* me kafe puro e *mbrëmave* me nga një pagure raki. (Sh. Musaraj, Isha unë Çobo Rrapushi, 6).

* * *

Për të njëjtat arësye, që parashtruam këtu më sipër, ne mendojmë se edhe format e rrjedhore së shquar njëjës të tipit *rrugës* (në funksionin e plotësit të vendit ose të kohës), *malit*, *fushës* etj. ose të dhanores së shquar shumës (me vlerë rrjedhoreje) *rrugëve(t)*, *malevet(t)*, *fushave(t)*, *grykave(t)*, *plllajave(t)*, *puseve(t)*, *krojeve(t)* etj. ose të rrjedhore së pashquar shumës *malesh*, të përdorura si plotës vendi, nuk janë të ndajfoljësuar, siç paraqiten nga disa gjuhëtarë. Ato nuk janë të çsubstantivuara as kuptimisht as gramatikisht. Sa për ilustrim po japim këtu nja dy shembëlla:

Rrugës po ta tregoj. (J. Xoxa, Lumi i vdekur, I/250). *Gjatë udhës* vetëm dy arësimtaret, që me sa duket, ishin shoqe, seç bisedonin vazhdimisht, kurse... (I. Kadare, Dasma, 54). — Po ju përcjellim, — tha Ismaili dhe, duke patur në një krah Sofikën dhe Manushaqen në krahun tjetër, shkuan *korridorit* (V. Kokona, Me valët e jetës, pj.II, f. 287). *Gjithë rrugës* ai sillte ndërmend burgun, ku s'e kishin lejuar të takohej me të jatin. (F. Gjata, Përmbysja, 70). *Gjithë udhës* thoshja me vete... (Sh. Musaraj, Isha unë Çobo Rrapushi, 5).

Është libri i tij i madh me fletë të përgjakura, që ne e çfletojmë pa pushim. Ai s'është shkruar këtu, por *grykave të maleve*, *plllajave*, buzë deteve. (Xhevahir Spahiu, «Në sallë ku gjëmon historia», «Zëri i Popullit» 4.V.1969, f.3). *Fushave*, *vreshtave* dhe *kopshtave* me ullinj të kooperativës bujqësore «Kongresi i pestë i partisë» të Nartës në rrethin e Vlorës zien puna plot vrull për të kryer shpejt dhe me cilësi të mirë punët bujqësore të stinës. («Zëri i Popullit», 9.V.1969, f.1).

7. Lidhur me vërejtjen eventuale se format në shqyrtim të kallëzores ose të rrjedhore së shquar njëjës dhe të dhanore-rrjedhore shumë përdoren në funksionet e plotësve të kohës e të vendit, që në shqipen e sotme ndërtohen zakonisht me ndajfolje a lokucione ndajfoljore kohe e vendi si edhe me togje të lira të tipit parafjalë + emër etj., do pasur parasysh se në shqipen e sotme përveç ndërtimeve gjuhësore produktive, ekzistojnë edhe disa ndërtime, që e kanë humbur gjallërinë e dikurshme. Por karakteri i kufizuar i përdorimit të një forme rasore pa parafjalë për të ndërtuar plotësa kohe ose vendi (ose ndonjë plotës tjetër), nuk mund të merret në asnjë mënyrë si një provë e çsubstantivimit të formave rasore të tipit *ditën*, *natën*, *verës*, *rrugës*, *të enjtevet*, *malevet*, *malesh* etj. Përndryshe, do të na duhej të prananim si një pro-

vë çsubstantivimi edhe karakterin e kufizuar të përdorimit të rrjedhës së pashquar njëjës pa parafjalë në ndërtimet e tipit *plasa vape, ngordha urie, ngriva së ftohti, mbarova së foluri, u lodha së foluri*¹⁶.

8. Lidhur me kushtin e tretë të ndajfoljzimit të një forme emërore ose foljore, meriton të shqyrtohet rasti kur një nga emrat e tipit *akull, borë, mjaltë, uthull, flakë* etj. (në përgjithësi emra konkretë lënde, që shquhen secili për një cilësi karakteristike) përdoret përpara ose (me rrallë) pas një mbiemri të caktuar, duke i dhënë atij mundësinë për ta shprehur cilësinë në një shkallë shumë të lartë. Përdorimi i secilit prej emrave të këtij tipi si mjet për të shprehur shkallën e lartë të një cilësie, mbetet i kufizuar në një rast të izoluar, duke qenë se mund të përdoret vetëm para (ose pas) një mbiemri të caktuar. Veç kësaj, do pasur parasysh se jashtë këtij funksioni as që mund të bëhet fjalë për përdorim ndajfoljor të emrave në shqyrtim. Kurse ndajfoljet intensifikuese *shumë, tepër* etj. nuk njohin asnjë nga këto dy kufizime, duke qenë se jo vetëm që mund të vihen para (ose pas) çdo mbiemri, që shpreh një cilësi të shkallëzueshme, por mund të përdoren edhe para një ndajfoljeje tjetër si edhe si përcaktuese të foljes ose të një emri prejfoljor asnjanes.

Por, nga ana tjetër, në togfjalëshat e tipit *akull i ftohtë, borë e bardhë* etj. emrat *akull, borë* etj. nuk funksionojnë si emra, sepse nuk ka si të mendohet që në një togfjalësh të formuar nga një emër dhe një mbiemër i pari të shërbejë si përcaktor i të dytit. Edhe ndryshimi i gjinisë së mbiemrit tek togfjalëshat në shqyrtim, pavarësisht nga gjinia e emrit *akull, (borë, etj.)* përbri, flet qartë për këtë (p.sh.: Uji ishte *akull i ftohtë*, Arançata ishte *akull e ftohtë*).

Edhe mendimi i shprehur nga A. Dhrimo «Stud. fil.» 2, 1969, 109, se edhe në togfjalëshat në shqyrtim emrat e tipit *akull, borë* etj. kanë vlerën e një mbiemri në sipërore, nuk na duket i mbrojtshëm¹⁷. Do pasur parasysh se, kur një emër adjektivohet, ai shërben si përcaktor i një emri tjetër (krahasor, p.sh. problem *kyç*, çështje *kyçe*, vend *mik*, fuqi *mike*) dhe jo i një mbiemri tjetër. Për më tepër, kur një emër adjektivohet, ai ka prirje të përshtatet me emrin, që përcakton, në gjini e numër (shih shembëllat më sipër), çka nuk ndodh tek emrat në shqyrtim.

Prandaj ne mendojmë se në togfjalëshat e tipit *akull i ftohtë, borë e bardhë* etj. emrat e tipit *akull, borë* etj. nuk funksionojnë as si emra, as si mbiemra. Por ata nuk paraqiten as si të ndajfoljzuar pa tjetër, sepse përdorimi i secilit prej tyre në funksion ndajfoljor paraqitet i kufizuar në një rast të izoluar. Në këtë rast mund të flitet vetëm për një ndajfoljzëzim funksional të izoluar si një idiomatizëm i gjuhës shqipe.

Edhe në shprehjet me karakter frazeologjik të tipit *ia thashë copë, e di ujë* etj. mund të flitet vetëm për një ndajfoljzëzim funksional të emrave të tipit *copë, ujë* etj. Është e vërtetë se në shprehjet, ku ata bëjnë pjesë, janë të barasvlershëm kuptimisht me ndajfoljet dhe gramatikisht paraqiten të ngurosur. Por përdorimi i tyre me vlerë ndajfoljore është i kufizuar funksionalisht në një rast të izoluar.

16) Për këto shih vërejtjet tona në «Studime filologjike», 1, 1969, III v.

17) Pak më poshtë ai pohon: «Në bashkëvjatje me mbiemrat përkatës mëvetësia funksionalisht mbiemërore e këtyre emrave zbehet për shkak të shfaqjes direkte të tiparit të dhënë nga mbiemri përkatës, edhe funksioni sintaksor i tyre ndihmon që nga semantika e vërtetë, *shumë + mbiemër*, të rroket vetëm *shumë*, pra në dukje u mbetet vetëm funksioni ndajfoljor «shkallëzues»...»

* * *

9. Për sa u takon togjevet të tipit *me guxim, me forcë, me nxitim, me inat, me hov, për inat etj.*, që disa gjuhëtarë i marrin si lokucione ndajfoljore¹⁸, ne mendojmë se ato nuk mund të merren si të tilla. Emrat e këtyre togjeve nuk i kanë humbur veçoritë emërore; ata mund të përdoren edhe në trajtë të shquar, kur përcaktohen nga një emër tjetër në rasën gjindore (ose nga një pronor) e mund të shoqërohen edhe me përcaktorë mbiemërorë; pra, nuk janë çsubstantivuar. P.sh.:

Me besim të patundur tek fjala e partisë, ai doli malit në radhët e çetës partizane të Kurveleshit, më vonë në çetën «Hajredin Tremishti». («Zëri i Popullit, 6.VI.1969, f.3»). Pastaj u mendua një copë herë e, duke marrë frymë thellë, shtoi *me shumë vështirësi...* (S. Spasse, Buzë liqenit, 292). Sot në mëngjez një grup punonjësish të uzinës «Enver» shkuan në kantierin e ndërtimit të ekspozitës dhe *me entuziazmin* dhe *hovin revolucionar, që i karakterizon*, punuan për disa orë përkrah puntorëve dhe teknikëve kinezë. («Zëri i Popullit», 18.VI.1969, f.1).

* * *

Megjithatë, në shqipen e sotme, sidomos në stilin publicistik, vihet re prirja që edhe togjet e këtij tipi të përdoren me pjesëzën ndajfoljore të krahasimit *më*. Në këtë rast ato paraqiten si të ndajfoljzuar. Veçse do pasur parasysh se kjo prirje ka përfshirë edhe togje të tilla si *në fund, në gjëndje, në thellësi* etj. që askush gjer më sot s'i ka menduar të ndajfoljzuar. Ja disa shëmbëlla sa për ilustrim.

a) ... unji kryet dhe filloi të punojë urtë e *më me nxitim* që të humbasë gjymën... (M. Kuteli, Netë shqipëtare, 63). — Ç'flet kështu, moj Frozë? — fola unë përsëri *më me inat...* (V. Vinçani, Lumturia, 36). Përplasi grushtin mbi tryezë dhe i mëshoi zërit *më me hakarri...* (S. Spasse, Buzë liqenit, 292).

b) Komitetet e partisë, nga ana e tyre, duke u përqëndruar në problemet më kryesore, do jenë *më në gjëndje* të kryejnë rolin udhëheqës. (Rev. «Rruga e Partisë», 1965, nr. 1, f. 14) ... u ngritën edhe shtëpi të tjera *më në thellësi*. (R. Brahim, Katër vajza, f. 27).

* * *

10. Pra, nga sa u shtjellua në këtë artikull, del se:

1) Duke qenë se pjesët e ligjëratës janë kategori leksiko-gramatikore, për të përcaktuar nëse një fjalë ka kaluar nga një pjesë e ligjëratës në një tjetër, duhet parë nëse ajo ka pësuar ndryshime të karakterit leksikor dhe gramatikor. (§1). Për ndajfoljzimin e një forme gramatikore (emërore ose foljore) është e nevojshme edhe që përdorimi i saj me vlerë ndajfoljore të mos jetë i kufizuar funksionalisht në një rast të izoluar (§§ 1, 4).

2) Si rrjedhim, format e emrave me kuptim të përgjithësuar të tipit *ditën, natën, të hënë etj., verës, dimrit* etj. të përdorura si plotës kohe,

18) Shih shën. 2.

rrugës, malit etj., të përdorura si plotës vendi, nuk janë të ndajfoljësuar. Përdorimi i tyre me kuptim të përgjithësuar, në kundërvënje me përdorimin e tyre me kuptim të individualizuar, nuk del jashtë caqeve të emrit; gjithashtu ato nuk e kanë humbur as aftësinë e lidhjevet sintaksore të emrit (§ 6).

3) Në togfjalëshat e tipit *akull i ftohtë, borë e bardhë* etj. emrat e tipit *akull, borë* etj. nuk funksionojnë si emra, por as janë të ndajfoljësuar pa tjetër, gjersa përdorimi i tyre me vlerë ndajfoljore është i kufizuar funksionalisht në një rast të izoluar. Në këtë rast mund të flitet vetëm për një ndajfoljzim funksional të izoluar si një idiomatizëm i shqipes. E njëjta vërejtje vlen edhe për emrat e tipit *copë, ujë* në shprehjet frazeologjike të tipit *ia thashë copë, e di ujë* etj. (§ 8).

4) Për ndajfoljzim togjesh të tipit parafjalë + emër mund të bëhet fjalë vetëm atëherë kur ato si kuptimisht ashtu edhe gramatikisht janë shndërruar në njësi të pandashme me vlerë ndajfoljore. Emrat në lokuacionet ndajfoljore të këtij tipi humbasin si kategoritë gramatikore ashtu edhe aftësitë e lidhjevet sintaksore përkatëse (§ 5).

5) Disa togje të lira të tipit parafjalë + emër, si p.sh. *me guxim, me forcë, në fund, në gjendje* etj., kanë filluar të përdoren, sidomos në stilin publicistik, edhe me pjesëzën e krahasimit *më*, duke u paraqitur kështu si të ndajfoljësuar. (§ 9). Në rast se kjo prirje do të thellohet më tej në të ardhmen, nuk përjashtohet mundësia që ajo të ndikojë edhe në ndajfoljzimin e vetë atyre togjeve, para të cilave mund të vendoset pjesëza *më*.

R é s u m é

DE L'ADVERBIALISATION DE CERTAINES FORMES GRAMMATICALES ET DE CERTAINS GROUPES DE MOTS DU TYPE PREPOSITION + NOM

Dans cet article l'auteur établit tout d'abord des critères concernant l'adverbialisation de certaines formes grammaticales nominales et verbales. D'après l'auteur, une forme nominale ou verbale ne passe à la classe des adverbies que lorsque:

1) Elle a subi des modifications importantes dans le contenu sémantique, en se transformant ainsi en une nouvelle unité lexicale d'un nouveau sens catégorial;

2) Par conséquent, elle a perdu les catégories grammaticales du nom, respectivement du verbe, et a pris les traits grammaticaux de l'adverbe, comme le sont l'absence de la flexion et la catégorie des degrés de comparaison;

3) Son usage à valeur adverbiale n'est pas borné fonctionnellement à un cas isolé.

C'est sur la base de ces critères que sont considérés adverbies les formes figées de l'accusatif indéfini singulier mot, vjet, ainsi que les formes figées de l'ablatif défini, respectivement indéfini: heret (de herë), motit, krejt (de krye), sheshit, fare (de farë). Comme adverbies sont considérés aussi les participes shkoqur, shtruar, hapur, prerë, etc. lorsqu'ils

sont usités dans les sens «clairement», «posément, sans se précipiter», «ouvertement», «d'une façon tranchée»; il en est de même des formes privatives: pa pandehur, pa pritur, pa rreshtur, lorsqu'elles sont usitées dans les sens de «impromptu», «inopinément», «incessamment».

L'auteur ne partage pas l'opinion de ceux qui affirment que les formes de l'accusatif défini singulier ditën, natën, të hënën, etc., ou bien de l'ablatif défini singulier verës, dimrit, udhës, malit, etc., employées comme compléments de temps, respectivement comme compléments de lieu, sont adverbialisées. Celles-ci n'ont pas subi une modification quelconque du sens catégorial et peuvent être associées à des déterminatifs adjectivaux et nominaux. Il est vrai que dans le dernier cas elles sont employées dans un sens individualisé, mais cela arrive aux noms en question même lorsqu'ils sont employés dans d'autres cas. D'autre part, l'opposition: sens généralisé / sens individualisé ne déborde pas les limites du nom.

L'auteur parle aussi d'une adverbialisation fonctionnelle des noms du type akull, borë, uthull, etc., dans des expressions idiomatiques: akull e ftohtë, borë e bardhë, uthull e thartë, etc. Dans ces groupes de mots, où l'adjectif exprime la qualité à un degré très haut, les noms du type akull, borë, uthull, etc. ne fonctionnent pas comme des noms, mais comme des mots d'intensité équivalente aux adverbes: shumë «très», tepër «trop», etc. Comme indice de désubstantivation de ces noms l'auteur rappelle aussi le fait que les adjectifs venant après (ou devant) eux ne s'accordent point (ex.: Arançata ishte akull e ftohtë). Il va sans dire qu'en cela on ne peut pas parler d'une adverbialisation inconditionnée, mais seulement d'une adverbialisation fonctionnelle, bornée à un cas isolé. Une semblable adverbialisation fonctionnelle voit l'auteur aussi dans les noms du type: copë, ujë, etc., dans les expressions phraséologiques du type: ia thashë copë, e di ujë etc.

*

Dans l'article ci-contre il est question aussi des locutions adverbiales formées par des groupes libres de mots du type préposition + nom. D'après l'auteur, on doit entendre sous le terme locution adverbiale un groupe de mots qui ont des liens durables entre eux et qui sous le double point de vue sémantique et grammatical sont équivalents, mais non point identiques, à un adverbe. La locution adverbiale, tant au point de vue de la sémantique que de celui grammatical, occupe une position intermédiaire entre le groupe libre de mots et l'adverbe, mais toujours plus proche à ce dernier. Par le passage du temps, les parties constituantes d'une locution adverbiale peuvent être agglutinées dans un seul mot, en passant ainsi définitivement à la classe des adverbes. Dans les locutions adverbiales du type préposition + nom, tant la préposition que le nom qui la suit ont perdu, qui plus qu'il moins, leur indépendance comme mots particuliers, en se modifiant ainsi, comme à dire, en une unité indissoluble à valeur et traits adverbiaux. Cela arrive surtout dans les locutions adverbiales au sens figuré du type në tym (= en vain, à l'obscur), prapa diellit (= à une très grande distance), etc. Dans ces locutions le nom perd les catégories grammaticales et l'aptitude des rapports syntaxiques, puisqu'il ne peut pas prendre, devant lui ou derrière lui, des déterminatifs avec ou sans accord. Il en est de même de la préposition qui perd sa capacité combinatoire, étant donné qu'elle n'est employée que devant une forme figée.

A l'avis de l'auteur, doivent être considérées comme locutions adverbiales aussi ces groupes de mots dans lesquels le nom se présente figé, c'est-à-dire qu'il a perdu les catégories grammaticales et la capacité des rapports syntaxiques, comme *me radhë* (= par ordre), *në këmbë*, (= debout), etc. Néanmoins, il fait observer que le degré d'adverbialisation dans ces cas est moindre que dans les locutions au sens figuré. Pour les mêmes raisons doivent être considérées comme des locutions adverbiales aussi les groupes de mots du type *me + nom adjectival neutre* (comme *me të keq*, *me të egër* etc.) ou bien du type *me + nom déverbatif neutre* (comme *me të qeshur*, *me të drojtur*, etc.). Le degré d'adverbialisation est plus haut dans les cas où le nom neutre (d'origine adjectivale ou verbale) n'est pas usité en dehors de la locution dont il fait partie.

L'auteur ne souscrit pas à l'opinion de ceux qui considèrent comme locutions adverbiales aussi les groupes de mots du type *préposition + nom* comme *me guxim*, *me hov*, etc., car les noms n'y sont pas désubstantivés. Ils n'ont perdu ni les catégories grammaticales, ni l'aptitude des rapports syntaxiques, car on dit aussi: *me guxim të madh*, *me guximin më të madh*, etc. D'autre part, l'auteur admet que quelques-uns des groupes de mots de ce type ont commencé d'être usité aussi avec la particule de comparaison *më* (ex.: *më me guxim*) et ce phénomène peut influencer à l'avenir sur leur adverbialisation.